

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Visar Gashi, në çështjen penale kundër të akuzuarit Rr.A., nga fshati Maqitevë, Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit Rr.A., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega Suharekë, P.nr.102/2017 të datës 22.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25.05.2018, morri këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së të akuzuarit Rr.A., aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Dega Suharekë, P.nr.102/2017, datë 22.05.2018, ndryshohet vetëm sa i përket vendimit mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarin Rr.A., e liron nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor. Në pjesët tjera aktgjykimi ngel i pa ndryshuar.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren – Dega Suharekë, me aktgjykimin P.nr.102/2017, datë 22.05.2018, të akuzuarin Rr.A., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar vërejtje gjyqësore. Është obliguar i akuzuari me shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor prej 20 (njëzet) €, në emër të ekspertizës së komunikacionit shumë prej 40.88 €, në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 50(pesëdhjetë) €, në emër të taksës për kompensim të viktimave shumë prej 30(tridhjetë)€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i akuzuari Rr.A., dhe atë për shpenzimet e procedurës penale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, ta aprovoj

ankesën si të bazuar, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj dhe të akuzuarin konform nenit 453 par.4 të KPP-së, ta liroj nga shpenzimet e procedurës penale.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.540/2018, datë 22.05.2018, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk animohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

I akuzuari aktgjykimin me të cilin është shpallur fajtor e kundërshton vetëm sa i përket shpenzimeve të procedurës penale me të cilën është ngarkuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, për faktin se është i gjendjes tejet të dobët ekonomike, i pa punë, mbajtës i familjes, jeton nga sociali ku në ankesë i është bashkangjitur edhe kartela e ndihmës sociale, prandaj sipas të akuzuarit me përmbushjen e obligimeve të cilat janë caktuar nga gjykata e shkallës së parë me rastin e shpenzimeve të procedurës penale, të njëjtit do ti rrezikohet gjendja materiale dhe anëtarëve të familjes ndaj të cilëve është i obliguar të kujdeset, prandaj pretendon dhe konsideron se ka bazë për lirimin e tërësishëm nga shpenzimet e procedurës penale, ashtu siç parashihet me dispozitën e nenit 453 par.4 të KPP-së dhe propozon që gjykata do ti ketë parasysh të lartcekurat në mënyrë që ta liroj nga shpenzimet e procedurës penale.

Kjo gjykatë gjeti se ankesa e të akuzuarit për lirim nga shpenzimet e procedurës penale është e bazuar ngase i akuzuari është i gjendjes tejet të dobët ekonomike, i pa punë, mbajtës i vetëm i familjes, jeton nga ndihma sociale dhe se ankesës ja ka bashkangjitur edhe kartelën e ndihmës sociale me nr. 15954 dhe se nga këto arsye kjo gjykata vlerëson se janë përmbushur

kushtet ligjore ashtu siç parashihet me dispozitën e nenit 453 par. 4 të KPPK-së ngase me pagesën e shpenzimeve të procedurës penale kjo gjykatë vlerëson se do të rrezikohet gjendja materiale e anëtarëve të familjes ndaj të cilëve përkujdeset.

Edhe pse i akuzuari nuk e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendimit mbi dënimin e shqiptuar - vërejtjen gjyqësore kjo gjykatë konform dispozitës së nenit 396 të KPP-së, e shqyrtoj edhe në këtë drejtim dhe gjeti se dënimi i shqiptuar - vërejtja gjyqësore të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë është adekuate dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit - vërejtjes gjyqësore.

Nga të cekurat më lartë konform të dispozitave të nenit 402 të KPPK-s u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.533/18, datë 25.05.2018

Zyrtari ligjor
Visar Gashi

Kryetari i kolegjit
Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani
Shqipe Qerimi